

Manual Përdorimi

MANUAL PËR LËSHIMIN E FATURËS SHOQËRUESE



Together we can
vodafone
business


Përmbajtje

Vodafone eBiznes	3
1.1 Hapat për lëshimin e faturës shoqëruese	4
1.1.1 Zgjedhja e procesit të faturimit	4
1.1.2 Lloji i faturës shoqëruese	4
1.1.3 Tipi i transaksionit	5
1.1.4 Informacioni mbi adresat	6
1.1.5 Informacion mbi transportuesin	6
1.1.6 Përfundimi dhe gjenerimi i faturës shoqëruese	7



Vodafone eBiznes

Vodafone eBiznes është zgjidhja më inovatore dhe më efikase për fiskalizimin e faturave tatimore edhe deklarimin e shitjeve në kohë reale te Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në përputhje me Ligjin nr. 87/2019 datë 18.12.2019, “Për Faturën dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit”.



Deklarim i shitjeve automatike & në kohë reale!




Aplikacion Mobile per Andorid dhe IOS



Lidhja e pajisjes me internetin mundësuar nga Vodafone



Raporte ditore dhe mujore të shitjeve



Përdorim i thjeshtë dhe i shpejtë

Biznesi yt një hap përpara


Zgjidhja jonë inovative eBiznes



1.1 Hapat për lëshimin e faturës shoqëruese


1.1.1 Zgjedhja e procesit të faturimit

Pasi janë zgjedhur artikujt të cilët do të transferohen klikohet butoni “Paguj” për të vijuar më tej me gjenerimin e faturës shoqëruese. Në dritaren dialoguese klikohet butoni “Faturë shoqëruese” sic tregohet në figurën më poshtë:



1.1.2 Lloji i faturës shoqëruese

Hapi i radhës është plotësimi i informacionit për llojin e faturës shoqëruese. Në rubrikën “Detajet e faturës”, klikohet në opsionin “Lloji i faturës” dhe në opsionet që shfaqen zgjidhet “Faturë shoqëruese pa ndryshuar pronësinë” nëse mallrat po transferohen pa ndryshim pronësie.




1.1.3 Tipi i transaksionit

Më pas, në rubrikën “Detajet e faturës”, klikohet mbi opsionin tjetër “Lloji i transaksionit” dhe zgjidhet lloji i përshtatshëm për transferimin që po kryhet, “Transferim nëpërmjet njësisë të biznesit”, “Shitje derë më derë”, apo llojet e tjera nëse bëhet fjalë për lëvizje karburantesh.

Llojet e faturës shoqëruese dhe kombinimi me transaksionet, duhet te përdoren si më poshtë:

- Sale (Shitje) – Dokument transporti (faturë shoqëruese me ndryshim pronësie) për rastet kur mallrat transportohen për t’u shitur, qoftë karburant apo çfarëdo malli tjetër, përtej përshkrimit që ka atributi.
- WTN (Transferim) – Faturë shoqëruese pa ndryshim pronësie kur mallrat transferohen nga njëra njësi e biznesit tek tjetra apo transferohen për riparime.



Lidhjat e llojit të faturës me transaksionin

Lloji i faturës shoqëruese	Lloji i transaksionit	Përdorimi
Sale	Sales	Përdoret për transferimin e mallrave kur ndryshon pronësia, pra shiten. Për sektorin e karburanteve si dhe për sektorë të tjerë të ekonomisë. Përdoret edhe për eksportet, pra shoqërimin e mallrave deri në doganë.
WTN	Examination	Përdoret për sektorin e karburanteve për rastet e verifikimit të pajisjeve dhe lëngut nga institucionet përgjegjëse të fushës (DPM). Për marrjen e mostrave të lëngut për verifikime.
WTN	Transfer	Përdoret për transferimin e mallrave (pa përcaktim sektori) kur nuk ndryshon pronësia, p.sh. nga magazine në magazinë, magazine pikë shitje, dyqan etj, dhe për rastet kur transferojmë një mall, artikull, object për riparim, të cilin e transferojmë përkohësisht tek njësi e biznesit e një tatimpaguesi tjetër.
WTN	Door	Përdoret për transferimin e mallrave nga magazine tek njësi e shitjes (automjeti) për shitjet derë më derë.



1.1.4 Informacioni mbi adresat

Në këtë hap plotësohen rubrikat përkatëse për adresën nga nisen mallrat dhe adresën ku dërgohen, datën e dërgimit, dhe informacion mbi shoqërimin apo rrezikshmërinë e mallrave. Fillimisht jepet informacioni nëse transporti kryhet nga pronari i mallrave apo nga një palë e tretë si dhe targa e automjetit të transportit. Pasi plotësohen të dhënat e plota mbi adresat klikohet butoni “Lëshuesi dhe transportuesi” i gjendur në fund të faqes.


1.1.5 Informacion mbi transportuesin

Në hapin e fundit ku jepet informacion, detajohen të dhënat e transportit. Zgjidhet lloji i ID-së së transportuesit, plotësohen e dhëna për atributin e zgjedhur, p.sh. NIPT-i, sic tregohet në figurën më poshtë, plotësohet emri, adresa dhe qyteti i transportuesit. Në përfundim, klikohet butoni “Preview” për të shfaqur pamjen paraprake të faturës shoqëruese që sapo u plotësua.



1.1.6 Përfundimi dhe gjenerimi i faturës shoqëruese

Nëse të dhënat që janë vendosur në faturën shoqëruese janë të sakta, veprimi i fundit është lëshimi dhe fiskalizimi i faturës shoqëruese dhe kjo bëhet duke klikuar butonin “Përfundo” që shfaqet në fund të faqes. Në këtë moment, fatura shoqëruese fiskalizohet dhe raportohet në mënyrë elektronike.



Ti mund ta kesh
biznesin në dorën
tënde.



Shkarko tani



Për tu lidh direkt me një agjent biznesi,
kliko **KËTU** dhe ne do ju telefonojmë.



vodafone
business

Together we can